



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1083/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të datës 19.11.2017.

A r s y e t i m

Me datën 18.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega Gjakovë, me të cilën ka pretenduar se kandidati për kryetar të Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini nga radhët e subjektit politik AAK, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë thirrje për të votuar AAK dhe propaganda tjera politike, përmes rrjetit social facebook. Në mbështetje të pretendimeve ankesës si provë i ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në përgjigjen në ankesë të datës 21.11.2017, ka theksuar se nga fotografia e ofruar nuk mund të shihet data e publikimit të tyre. Më tej ka theksuar se AAK ka vepruar në baz të Ligjit Nr.11/2013 neni 3.3, 3.4 dhe 3,6 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta respektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes.

Duke i bashkangjitur lajmrimin publik të AAK-së për respektimin e e Kodit Zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal të Gjakovës, Ardian Gjini, nga radhët e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e

LZP-së, për arsye se Ardian Gjini, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Gjakovë, nuk mund të vërtetohet se ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore pasi që nga fotografitë e shpërndara në rrjetin social facebook, nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së fotografive.

Andaj në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 dhe neni 118 të LZP-së paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.1083/2017 më datën 21.11.2017



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*